



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d), nenit 52 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1, nenit 26 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e tretë të rregullt, e mbajtur më datën 27.05.2020, merr këtë:

V E N D I M Nr.14/2020/KG

për miratimin e Raportit tremujor financiar për vitin 2020

Neni 1

Miratohet Raporti tremujor financiar i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave për vitin 2020.

Raporti i miratuar tremujor financiar për vitin 2020 është paraqitur në tabelën dhe tekstin e mëposhtëm:

Nr. r	Kategoria ekonomike	Vlera e buxhetit	Alokimi për 3 muaj	Shpenzimet për 3 muaj	% nga shuma e buxhetit	% nga shpenzimet e alokuara	% nga alokimi i buxhetit
1.	Pagat dhe medijtjet	2,982,483.00	732,853.17	732,853.17	24.57	100.00	34.76
2.	Mallrat dhe shërbimet	1,343,633.25	624,188.00	224,105.99	16.68	35.90	29.61
3.	Shërbimet komunale	180,750.00	72,250.00	35,187.44	19.47	48.70	3.43
4.	Subvencionet dhe transferet	212,109.00	39,252.09	21,000.00	9.90	53.50	1.86
5.	Shpenzimet kapitale	5,753,817.88	636,403.00	0.00	0.00	0.00	30.18

6.	Donacionet	3,432.71	3,432.71	1,203.46	35.06	35.06	0.16
7.	TOTAL	10,476,225.84	2,108,378.97	1,014,350.06	9.68	48.11	100.00

Në tabelën e mësipërme shihet se buxheti i Komunës së Graçanicës për tremujorin e parë të vitit 2020 është 10,476,225.84€. Nga shuma totale prej 10,472,793.13 € janë grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake, kurse 3,432.71€ janë donacionet e jashtme.

Nga buxheti total për vitin 2020 për paga dhe mëditje janë ndarë 2,982,483.00€ apo 28,47%, për mallra dhe shërbime janë ndarë 1,343,633.25€ apo 12,83%, për shërbime komunale janë ndarë 180,750.00€ apo 1.73%, për subvencione dhe transfere janë ndarë 212,109.00€ apo 2.02%, për shpenzime kapitale janë ndarë 5,753,817.88 apo 54.92% dhe për donacione 3,432.71€ apo 0,03%.

Në tremujorin e parë është kryer alokimi i mjeteve në një shumë prej 2,108,378.97€ apo 20,13% nga buxheti i përgjithshëm. Sipas kategorive ekonomike është kryer alokimi në shumat e mëposhtme:

- 1) Për paga dhe medijtje në një shumë prej 732,853.17€ apo 24.57% nga buxheti
- 2) Për mallra dhe shërbime në një shumë prej 624,188.00€ apo 46,46% nga buxheti
- 3) Për shërbime komunale në një shumë prej 72,250.00€ apo 40,11% nga buxheti
- 4) Për subvencione dhe transfere në një shumë prej 39,252.09€ apo 18.51% nga buxheti
- 5) Për shpenzime kapitale në një shumë prej 636,403.00€ apo 11,06%
- 6) Për donacione në një shumë prej 3,432.71€ apo 100,00%

Në tremujorin e parë janë shpenzuar 1,014,350.06€ apo 9,68% nga buxheti i përgjithshëm apo 48,11% nga mjetet e alokuara për tremujorin e parë.

Sipas kategorive ekonomike janë shpenzuar mjetet si në vijim:

- 1) Për paga dhe medijtje janë shpenzuar 732,853,17€ apo 24,57% nga buxheti i përgjithshëm apo 100,00% nga mjetet e alokuara
- 2) Për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 224,105.99€ apo 16,68% nga buxheti i përgjithshëm apo 35,90% nga mjetet e alokuara
- 3) Për shpenzime komunale janë shpenzuar 35,187.44€ apo 19,47% nga buxheti i përgjithshëm apo 48,70% nga mjetet e alokuara
- 4) Për subvencione dhe transfere janë shpenzuar 21,000.00€ apo 9,90% nga buxheti i përgjithshëm apo 53,50% nga mjetet e alokuara
- 5) Për shpenzime kapitale janë shpenzuar 0.00€ apo 0,00% nga buxheti i përgjithshëm apo 0,00% nga mjetet e alokuara
- 6) Për donacione janë shpenzuar 1,203.46€ apo 35,06% nga buxheti i përgjithshëm apo 35,06% nga mjetet e alokuara

Në tremujorin e parë janë realizuar të hyrat vetanake në një shumë prej 1,196,834.16€ apo 66,97% nga të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2020 dhe të njëjtat janë alokuar në kategoritë ekonomike si në vijim:

- Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë alokuar 139,681.50€
- Në kategorinë e shpenzimeve komunale janë alokuar 26,000.00€
- Në kategorinë e subvencioneve janë alokuar 180,859.00€
- Në kategorinë e investimeve kapitale janë alokuar 850,293.66€

Në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2019 janë shpenzuar 476,163.59€ më pak apo 46,94%, ndërsa të hyrat vetanake për 865,948.77€ apo 361,71% janë më larta në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2019.

VËREJTJE: Meqenëse buxheti për vitin 2020 nuk është miratuar, shuma e buxhetit për tremujorin e parë bazohet në 1/12 e buxhetit nga viti 2019.

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Ljubiša Karadžić